



BASHKIMI I SINDIKATAVE TË PAVARURA TË KOSOVËS
SINDIKATA E PAVARUR E ADMINISTRATËS SË KOSOVËS
Shoqata Sindikale e Administratës Komunale Suharekë

PËR:	-Komitetit për Politikë dhe Financa- KK Suharekë dhe -Kuvendit Komunal-Suharekë
Nga:	Kryesia e Shoqatës Sindikale të Administratës Komunale në Suharekë
Përmes:	Xhavit Fondaj - Kryetar i SHSAK në Suharekë
TEMA	Kërkesë për pagesen e shujtës për punëtorët e Administratës së Komunës së Suharekës
Data.	03.02.2022

Të nderuar/a zonja dhe zotërinj!

Me kërkesen e punëtorëve të Administratës Komunale të KK Suharekë, për përmirsimin e pozitës materiale, në takimin e Kryesisë së Shoqatës Sindikale të Administratës Komunale të Suharekës u diskutua edhe për çështjen e pozitës materiale të punëtorëve të Administratës së Komunës së Suharekës, të rënduar edhe më shumë kohët e fundit, me rastin e ngritjes së çmimeve enorme në të gjitha produktet të domosdoshme për jetë.

Si konstatim i përgjithshëm ishte se pozita materiale e punëtorëve të Administratës të Komunës është më e pa favorshme krahasuar me pozitën e punëtorëve në arsim, shëndetësi dhe sektorët tjerë. Sistemi i pagave të tanishëm i favorizon shumë më tepër të punësuarit në këta sektor, krahasuar me të punësuarit në Administratën Komunale. Pos pagave më të ulëta, punëtorët në Administratën Komunale, nuk gëzojnë as të drejtën e kompensimit të shujtës siq e gëzojnë punëtorët e Arsimit dhe Shëndetësisë.

Me qëllim të përmirësimit të gjendjes të të punësuarëve në Administratën Komunale, ne si kryesi, **Ju drejtohem me këtë kërkesë që nga dt.01.01.2022, të bëhet kompensimi i shpenzimeve të shujtës (prej 3.50 euro në ditë) për punëtorët e Administratës të Komunës sonë, për shkak të arësyrave të cekura më lartë.**

Me që numri i të punësuarëve në administratën e komunës është dukshëm më i vogël se i të punësuarëve në arsim, konsiderojmë se shuma për kompenzim të shujtës, nuk do të paraqet ndonji ngarkesë të pa përballueshme për buxhetin e Komunës.

Me respekt!